




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-18828/20 datë:21.09.2020



Npi – 01/208 Datë: 29.09.2020

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 14 të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës Nr.05/L-055, ku lidhet me rrjedhën e zbatimit të Planit të veprimit dhe njoftimi periodik i Kuvendit për progresin në zbatimin e rekomandimeve. Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 29.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

**PËR APROVIMIN E RAPORTIT PERIODIK PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më datën: 29.09.2020 me shumicën e votave aprovoi, Raportin Periodik për zbatimin e Rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

II

Raporti Periodik, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj